



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:021852

Datë: 20.02.2024

Numri i dokumentit: 05349661

KA.nr.1278/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Tensor I.S.S. L.L.C” SH.P.K., me numër unik identifikues ... me seli në Prishtinë, Rruga “Raif Pollomi” B/14, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V. B., avokat nga Prishtina me adresë në Rrugën “Muharrem Fejza” C15/17, nr. 5, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, rr. “Migjeni” p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Nj. S., për shkak të anulimit të Vendimit PSH.nr.202/22 të datës 29.07.2022, pas shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur me datë 05.02.2024 në prezencë të përfaqësuesit të paditësit dhe në mungesë të paditurit, me datë 20.02.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Tensor I.S.S. L.L.C” SH.P.K., kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit.
- II. NDRYSHOHET Vendimi PSH.nr.202/22 të datës 29.07.2022 i nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, ashtu që aprovohet ankesa e datës 13.06.2022 e ushtruar nga paditësi “Tensor I.S.S. L.L.C” SH.P.K., ANULOHET në tërësi aktiviteti i prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për sistemin e kamerave” me nr. të prot.: 254-22-3922-1-3-6 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.
- III. Ky Aktgjykim e zëvendëson aktin e ndryshuar dhe anuluar dhe ka karakter detyrues.
- IV. Shtyrja e ekzekutimit të Vendimi PSH.nr.202/22 të datës 29.07.2022, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.1278/22 i datës 15.11.2022, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Tensor I.S.S. L.L.C”, SH.P.K. përmes përfaqësuesit të autorizuar ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me kërkesën për anulimin e Vendimit PSH.nr.202/22 të datës 29.07.2022 si të kundërligjshëm. Paditësi përmes padisë ka theksuar se vendimi i kontestuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale, ashtu që vendimi i kontestuar është në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që nuk përmban elementet obligative të aktit administrativ. Tutje ka shtuar se Operatori Ekonomik (OE) fitues ka ofertuar me pajisje të cilat i takojnë prodhuesit kinez “Dalhua”, e që sipas paditësit “Dalhua” së bashku me “HikVision”, “Huawei”, “ZTE” dhe “Kaspersky” janë brende të cilat janë të ndaluara për shitje, distribuim dhe përdorim në SHBA me vendim të Komisionit Federal të Komunikimeve, me rregullore të Departamentit të Shtetit Amerikan të Mbrojtjes dhe së fundmi me Ligjin për Komunikime të Sigurta të nënshkruar më 11.11.2021 nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Në këtë drejtim paditësi konsideron se Ligjet dhe Konventat Ndërkombëtare janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, andaj edhe Qeveria e Kosovës ka nxjerr dy vendime me nr.07/66 të datës 23.02.2021 me të cilin vendos që të gjitha sanksionet e SHBA-ve dhe BE-së janë të zbatueshme në Kosovë, dhe vendimin 05/03 të datës 02.04.2021, ku ndalon zyrtarët e caktuar të Republikës Popullore të Kinës të veprojnë në Kosovë, ndërsa shton se aksionare kryesore e brendit “Dalhua” është Qeveria e Kinës. Më tej shton se paditësi është kontraktues i Ushtrisë Amerikane dhe NATO-S për sisteme të Sigurisë dhe në aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje për sistemin e kamerave” me nr. protokollit 254-22-3922-1-3-6 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajrorë, ka përmbushur në mënyrë të plotë detyrat dhe përgjegjësitë e parapara në Dosjen e Tenderit. Si përfundim ka theksuar se vendimi i kontestuar është i përfshirë në shumë shkelje ligjore, fillimisht nënvizon vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike e më pas edhe shkeljet procedurale ashtu që për palët nuk është ofruar një akt administrativ i arsyetuar siç kërkojnë dispozitat ligjore. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, të anuloj vendimin e PSH.nr.202/22 të datës 29.07.2022 si të kundërligjshëm si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I padituri përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigjen në padi, përmes të cilës e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit duke shtuar se nuk qëndron pretendimi i paditësit se brendet kineze janë të ndaluara në territorin e Republikës së Kosovës. Tutje ka theksuar se gjatë analizës së aktivitetit të prokurimit ka evidentuar shkelje të bëra gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nga ana e AK, konkretisht shton se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore nga neni 108/A par. 2 të Ligjit për Prokurimin Publik, mirëpo për këtë Paneli Shqyrtues ka theksuar se do të marr masa konform dispozitave ligjore e cila rrjedhimisht nuk e ndryshon çështjen substanciale të dispozitivit të vendimit të kontestuar. Si përfundim i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim PSH.nr. 202/22 i datës 29.07.2022; Ankesë e datës 13.06.2022; Vendim nr. 05/03 i datës 02.04.2021 i Qeverisë së RKS; Njoftim i KRPP për Autoritetet Kontraktuese; Raporti i ekspertit shqyrtues i datës 24.06.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 41 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e në tërësi e bazuar.

Me Vendimin PSH.nr. 202/22 të datës 29.07.2022, Paneli Shqyrtues i OSHP i ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit “Tensor I.S.S.” L.L.C. dhe kishte vërtetuar Njoftimin për Dhënien e Kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje për sistemin e kamerave” me nr. protokollit 254-22-3922-1-3-6 të iniciuar nga AK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 99 par. 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenin 56 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, i cili përcakton se: “3. Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative” si dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i

cili përcakton: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”.*

Gjykata i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit për anulimin e vendimit kontestues pasi që i padituri nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore, procedurale dhe materiale pasi që vendimi i kontestuar nuk është nxjerr konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nuk janë shqyrtuar drejtë provat për vërtetimin e gjendjes së saktë faktike.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga Ankesa e datës 13.06.2022, gjykata konstaton se paditësi kishte ushtruar ankesë ndaj Njoftimit për Dhënie të Kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje për sistemin e kamerave” të iniciuar nga AK Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Nga Vendimi nr. 05/03 i datës 02.04.2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës (RKS), gjykata konstaton se përmes këtij vendimi Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Vendimit (CFSP) 2021/481 e Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 22.03.2021, i cili ndryshon dhe plotëson Vendimin CFSP 2020/1999 në lidhje me masat kufizuese kundër shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut dhe abuzimeve të datës 07.12.2020 ndaj katër personave njëri prej tyre kinez.

Nga Njoftim i KRPP për Autoritetet Kontraktuese, gjykata konstaton se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik kishte njoftuar AK që në procedurat e tyre të prokurimit të ndalojnë kontraktimin e pajisjeve të prodhuara nga kompanitë si: “Dalhua Technology Company” “HikVision Digital Technology Company”, “Huawei Technologies Company”, “ZTE Corporation”, “Hytera Communications Corporation” dhe “AO Kaspersky Lab”.

Nga Raporti i ekspertit shqyrtues i datës 24.06.2022, gjykata konstaton se aktiviteti i prokurimit “Furnizim me pajisje për sistemin e kamerave” sipas Ekspertit Shqyrtues të Prokurimit brendet kineze nuk kanë ndalesë të përdorimit në Republikën e Kosovës, andaj ka rekomanduar që të refuzohet pjesërisht si e bazuar ankesa dhe të lihet në fuqi vendimi Njoftimi për Dhënie të Kontratës.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua nenit 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP) i cili përcakton se: *“1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.”*, si dhe nenit 4 të Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) i cili parasheh: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.”*

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar në kundërshtim me LPP-në dhe LPPA-në, kur fillimisht refuzon si të pabazuar ankesën e paditësit e më pas vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm Njoftimin për Dhënien e Kontratës të nxjerr nga AK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Gjykata gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur, ju referua nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare i cili përcakton se: *“1. Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare specifikohet dhe ndryshohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me përjashtim të rastit që i referohet paragrafi 1 të nenit 8 të këtij ligji. 1.1. vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës përcaktojnë se cilat sanksione zbatohen, kufizimet kohore për zbatimin sanksioneve të tilla, kushtet, heqjen e mundshme dhe entitetet ndaj të cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare; 1.2. një datë e skadimit të sanksioneve ndërkombëtare caktohet duke llogaritur datën e skadimit të paraqitur me vendimet e organizatave ndërkombëtare që kanë vënë sanksionet ndërkombëtare; 1.3. afatet kohore për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës nuk përcaktohen, nëse një organizatë ndërkombëtare, e cila ka vendosur afatet e tilla, e parasheh mundësinë për ripërtëritjen e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare pas rishikimit i cili bëhet në rastin e skadimit të afateve kohore për zbatimin e sanksioneve të përmendura”*, lidhur me nenin 8 par.1: *“1. Ndalohet kryerja e veprimeve, përfundimi i të cilave është i ndaluar me sanksionet ndërkombëtare të zbatuara në Republikën e Kosovës. Veprimet, si përfundim përpara se të bëhet vendosja e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës përfundojnë në mënyrë të*

njëanshme ose përmes marrëveshjes në mes të palëve. Ekzekutimi i tyre ndërpritet gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare.”.

Gjithashtu në bazë të Vendimit nr. 07/66 të datës 23.02.2021 të Qeverisë së RKS, pika 1. është përcaktuar se: *"Zbatohen sanksionet ekonomike ndërkombëtare ndaj entiteteve dhe personave fizikë të përcaktuar sipas listave të sanksioneve të vendosura nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës."* si dhe pika 4. ku thekson se: *"Obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi në pajtim me legjislacionin në fuqi".* Andaj, duke qenë se Qeveria e RKS nuk ka bashkangjitur listë të entiteteve ndaj të cilave aplikohen sanksionet por, sipas vendimit mbështetet në listat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Bashkimit Evropian (BE) dhe SHBA-ve, gjykata ju referua Njoftimit Publik DA 21-309 të datës 21.03.2021 i lëshuar nga Komisioni Federal i Komunikimeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për publikimin e listës së pajisjeve dhe shërbimeve të përfshira nga pjesa 2 e Aktit të Rrjeteve të Sigurta, i cili në pikën 5 ka përcaktuar ndalesën si në vijim: *"Pajisjet për mbikëqyrje me video dhe telekomunikacionit të prodhuara nga "Dahua Technology Company, në masën që përdoren për qëllime të sigurisë publike, sigurinë e objekteve qeveritare, mbikëqyrjen e sigurisë fizike të infrastrukturës kritike dhe qëllime të tjera të sigurisë kombëtare, duke përfshirë shërbimet e telekomunikacionit ose të mbikëqyrjes me video të ofruara nga subjekti i tillë ose duke përdorur pajisje të tilla."*¹

Sipas kësaj liste të publikuar nga Komisioni Federal i Komunikimeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kompanitë të cilat evidentohen që paraqesin kërcënim për sigurinë kombëtare janë, "Dahua Technology Company", "Hangzhou Hikvision Digital Technology Company", "Hytera Communications Corporation", "ZTE Corporation" dhe "Huawei Technologies", ndalesa për të cilat është vendosur nga data 12.03.2021.²

Nga provat e administruara rezulton se brendi me të cilin ka ofertuar OE fitues është brend i sanksionuar nga SHBA, e që rrjedhimisht me Vendimin Nr. 07/66 të datës 23.02.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë zbatuar sanksionet ekonomike ndërkombëtare ndaj etniteteve dhe personave sipas listave të OKB, BE dhe SHBA. Në këtë drejtim gjykata gjeti se

¹ "Komisioni Federal i Komunikimeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës publikon listën e pajisjeve dhe shërbimeve të komunikimit që paraqesin kërcënim për sigurinë" (Shih linkun: [FCC List of Equipment and Services That Pose National Security Threat | Federal Communications Commission](#)) qasur së fundmi më 13.02.2024.

² Po aty.

nga lista e publikuar nga Komisioni Federal i Komunikimeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, “Dahua” evidentohet si brend i sanksionuar dhe që paraqet kërcënim për sigurinë.

Gjykata vendosi që të ndryshojë Vendimi PSH.nr.202/22 të datës 29.07.2022 dhe të anulojë në tërësi aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për sistemin e kamerave” me nr. të prot.: 254-22-3922-1-3-6 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në kuptim të nenit 43 të LKA-së i cili përcakton se: *“1. Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. 2. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ. 3. Nëse anulimi i aktit administrativ, sipas paragrafit 2. të këtij neni dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohej, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin”*. Andaj, gjykata duke pasur parasysh edhe urgjencën në trajtimin e ligjshmërisë së aktit kontestues, meqë aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me furnizimi me pajisje për sistemin e kamerave për një institucion publik, gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e akteve të goditura me padi në mënyrë meritore dhe vendosi vetë për çështjen, pasi që të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës kanë dhënë bazë të sigurt për vendosjen e çështjes administrative nga gjykata.

Gjykata vendosi vetë për çështjen mbështetur në nenin 46 par. 4 të LKA-së i cili përcakton se: *“4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e*

zëvendëson aktin e anuluar". Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se fillimisht autoriteti kontraktues Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror me rastin e inicimit të aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje për sistemin e kamerave" me nr. të prot.: 254-22-3922-1-3-6 me rastin e përcaktimit të specifikimeve teknike nuk ka ndalur pajisjet që paraqesin rrezik për sigurinë kibernetike dhe infrastrukturën kritike të vendit dhe rrezik për sigurinë kombëtare të vendit në përputhje me Vendimin Nr. 07/66 të datës 23.02.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe sanksioneve ekonomike ndërkombëtare ndaj entiteteve dhe personave fizikë të përcaktuar sipas listave të sanksioneve të vendosura nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu që gjykata vendosi në mënyrë meritorë si në pikën II të dispozitivit.

Gjykata vlerëson se vetëm me anulimin e tërësishëm të këtij aktiviteti të prokurimit do të sigurohet zhvillimi i një aktiviteti të drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore duke mbrojtur kështu integritetin e aktivitetit të prokurimit dhe ruajtjen e sigurisë kibernetike dhe infrastrukturën kritike të vendit dhe sigurinë kombëtare.

Lidhur me propozimin e paditësit për nxjerrjen e ekspertizës nga lëmi financiar në mënyrë që të përcaktohen dëmet e cilat u kanë shkaktuar paditësit nga vendimi i kundërligjshëm, gjykata vendosi që të refuzoj propozimin e paditësit pasi që është me interes publik që kjo çështje të zgjidhet pa ndonjë vonesë duke qenë se gjykata përmes Aktvendimit KA.nr.1278/22 ka shtyrë ekzekutimin e Vendimit PSH.nr.202/22 të datës 29.07.2022 dhe duke pasur parasysh rëndësinë e këtij aktiviteti të prokurimi, gjykata vlerësoi se është më me interes që fillimisht të zgjidhet çështja e ligjshmërisë së aktit të kontestuar dhe pastaj mund të vlerësohet dëmi eventual i shkaktuar nga akti administrativ në procedurë civile.

Gjykata la në fuqi shtyrjen e ekzekutimit të Vendimi PSH.nr.202/22 të datës 29.07.2022, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.1278/22 i datës 15.11.2022, konform nenin 309 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të LKA, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 par.3 dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë
Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.1278/22, datë 20.02.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.